



**GRUPI PARLAMENTAR I PARTISË DEMOKRATIKE
GRUPI I KËSHILLTARËVE BASHKIAK TË PARTISË DEMOKRATIKE**

KËRKESE

**PËR SHKAKRKIM E MENJËHERSHËM NGA DETYRA TË KRYETARIT TË
BASHKISË DURRËS Z. VANGJUSH DAKO**

**DREJTUAR: KËSHILLIT TË MINISTRAVE
ZOTIT EDI RAMA – KRYEMINISTËR**

**BAZA LIGJORE: NENI 115 I KUSHTETUTËS, SI DHE NENI 62 I LIGJIT NR.
139/2015 “PËR VETËQEVERISJEN VENDORE”**

Zoti Kryeministër,

Zonja dhe zotërinj anëtarë të Këshillit të Ministrave,

Është fakt i njohur publik tashmë se Kryetari i Bashkisë Durrës Vangjush Dako, ka kryer një shkelje të rëndë të ligjit, duke ushtruar veprimtari që del jashtë funksioneve të tij si Kryetar Bashkie dhe duke favorizuar lirim nga burgu të një anëtar të krimit të organizuar. Konkretisht, bazuar në vendimin e Gjykatës së Apelit Durrës për lirim e antarit të krimit të organizuar Lulzim Berisha, rezulton se nëpërmjet një garancie të paligjshme dhe të pabazuar në Kushtetutë, ligj apo akt nënligjor, Kryetari i Bashkisë Durrës ka siguruar gjykatën se nëse i dënuari do të lirohet para kohe me kusht, ai merrte përsipër punësimin e tij.

Në këtë rast, Kryetari i Bashkisë së Durrësit, ka kryer shkelje të rëndë të ligjit, për shkak se jashtë rasteve të lejuara nga ligji dhe në kundërshtim me ligjin, ka garantuar punësimin e të dënuarit Lulzim Berisha, në pamundësi për tu punësuar në ndonjë subjekt privat. Kjo garanci e dhënë nga Kryetari i Bashkisë, dhe që ka shërbyer si argument për lirim nga burgu të të dënuarit Lulzim Berisha, nuk mbështetet në asnjë dispozitë ligjore në fuqi dhe del tërësisht jashtë fushës së veprimtarisë së Kryetarit të Bashkisë.

Për pasojë, Kryetari i Bashkisë Durrës Vangjush Dako, ka kryer veprimtari në kundërshtim me urdhërimin e pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 139/2015, ku specifikohet se: “2. Në veprimtarinë e tyre organet e njësisve të vetëqeverisjes vendore

respektojnë dhe zbatojnë Kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore.” Vetë Kryetari i Bashkisë ka pranuar se publikisht se nuk mund të punësojë persona që kanë gjendjen gjyqësor “i dënuar” për shkak se e ndalon ligji. Nga ana tjetër, asnjë institucion shtetëror, përfshirë këtu edhe Kryetarin e një njësie vendore, nuk mund të lëshojë akte të cilat nuk kanë asnjë mbështetje ligjore, për shkak se kjo përbën shkelje të rëndë të nenit 4 të Kushtetutës, ku specifikohet se “*E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit*”. Ndër të tjera kjo dispozitë sanksionon se asnjë organ shtetëror nuk mund të veprojë jashtë kufijve që i ka vendosur ligji.

Justifikimi i deklaruar publikisht nga Kryetari i Bashkisë Vangjush Dako, sipas të cilit bëhet fjalë për punë vullnetare dhe papagesë, është i pambështetur ligjërisht. Askush nuk mund të punësohet në mënyrë vullnetare në një institucion shtetëror, sepse puna duhet të shpërblehet, ndryshe përbën cenim të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Një i dënuar mund të detyrohet të punojë pa pagesë vetëm në rastin e një vendimi gjyqësor, që i pezullon dënimin dhe e detyron të kryejë një punë në interes publik (aplikimi i dënimit alternative të parashikuar në nenin 63 të Kodit Penal). Në këtë rast, nuk është i nevojshëm garantimi i punësimit nga institucioni shtetëror, për shkak se ky i fundit është i detyruar që të zbatojë vendimin e gjykatës. Mirëpo, ky nuk është rasti i të dënuarit Lulzim Berishës, i cili kishte aplikuar për lirim me kusht në kuptim të nenit 64 të Kodit Penal dhe ku garancia e punësimit të tij nga Kryetari i Bashkisë Vangjush Dako ka shërbyer si argument për të konkluduar se i dënuari do të jetë në gjendje të ketë një punësimit të siguar që garanton rehabilitimin.

Përsa më lart, vlerësojmë se Kryetari i Bashkisë Durrës Vangjush Dako ka kryer shkelje të rëndë të ligjit, për shkak se ka lëshuar vërtetim për punësim, pa u mbështetur në asnjë ligj në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Neni 62 i ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, përcakton se: “**Kryetari i bashkisë shkarkohet me vendim të Këshillit të Ministrave në rastet kur kryen shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve.**”. Në këto kushte, kërkojmë nga Këshilli i Ministrave, që në mbështetje të nenit 115 të Kushtetutës dhe shkronjës “a” të nenit 62 të ligjit nr. 139/2015, të shkarkojnë menjëherë nga detyra Kryetarin e Bashkisë Durrës Vangjush Dako. Ky do të ishte një tregues i qartë se Këshilli i Ministrave vepron menjëherë jo vetëm në rastet kur konstaton shkeljen e ligjit, por ndaj cilido që ndërmer veprime aktive për të mbështetur personat e përfshirë në krimin e organizuar. Qartësisht në këtë rast, veprimet e Kryetarit të Bashkisë Durrës kanë favorizuar në mënyrë të paligjshme, një të dënuar të njohur botërisht si peson me rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe anëtar i krimit të organizuar.

Me bindjen se reagimi i Këshillit të Ministrave do të jetë i shpejtë dhe në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin, si dhe duke e konsideruar reagimin tuaj si fakt që provon

se jeni kundër dhe jo pjesëmarrës në favorizimin e anëtarëve të kriminit të organizuar, kërkojmë pranimin e kërkesës sonë pa asnjë vonesë të mëtejshme.

DEPUTETËT E PARTISË DEMOKRATIKE, QARKU DURRËS:

Derol Gjylkebasliu
Gent Shafiu
Alban Vlash.
Edmond Kelm
Igari Cora

KËSHILLTARËT BASHKIAK TË BASHKISË DURRËS, ANËTARË TË GRUPIT TË PARTISË DEMOKRATIKE:

Armand Iliu
Anelisa Lika
Arylla Fico
Mira Lami
Raminolaj Skerri
Rukije Sulaj

Shkëlqim Fortuzi
Jvo Jorgovan
Ambera Duka
Gruzele Lela
Enteleda Kertusha